

Projekti kërkimor *Vlerësimi i ligjit dhe rregullores për zhvillimin e mëtejshëm të migracionit të fuqisë punëtore të kualifikuar*

Informacion mbi mbrojtjen e të dhënave sipas nenit 13 dhe nenit 14 të Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (DSGVO)

Projekti kërkimor

Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF) dhe Instituti për Kërkime të Tregut të Punës dhe Profesioneve (IAB) po kryejnë kërkime mbi zbatimin administrativ të *ligjit dhe të rregullores për zhvillimin e mëtejshëm të imigrimit të fuqisë punëtore të kualifikuar (FEG 2.0)*, me titull "*Vlerësimi i ligjit dhe i rregullores për zhvillimin e mëtejshëm të imigrimit të fuqisë punëtore të kualifikuar*". Në këtë kuadër po shqyrtohet se cilat janë sfidat ekzistuese në zbatimin administrativ të ligjit, veçanërisht nga këndvështrimi i personave që kanë emigruar. Gjithashtu po analizohet më në detaje integrimi në tregun e punës i fuqisë punëtore dhe i specialistëve që sapo kanë emigruar.

Do të anketohet një kampion përfaqësues i zgjedhur në mënyrë rastësore, ku emigrantët me leje qëndrimi për punësim në bazë të një përvojë profesionale praktike të zgjeruar (neni 19c, paragrafi 2 i Ligjit "Për qëndrimin në Gjermani" së bashku me nenin 6 të Rregullores për Punësimin) si dhe personat e pajisur me Kartën e Mundësive (sipas nenit 20a të ligjit "Për qëndrimin në Gjermani") do të kontaktohen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, do të përfshihen në mënyrë disproporcionale në këtë kampion edhe personat me leje qëndrimi sipas nenit 16d të ligjit "Për qëndrimin në Gjermani".

Ftesa për pjesëmarrje në pyetësor bëhet përmes një linku, i cili u dërgohet me postë personave që anketohen, në portalin online INGRESS. Nëpërmjet INGRESS-it zhvillohet më pas pyetësori.

Portali online INGRESS menaxhohet nga Ingress GmbH, një ofrues shërbimi i IAB-it. Ingress GmbH e zbaton teknikisht pyetësorin përmes portalit të tij online dhe ua përcjell të dhënat e mbledhura në kuadër të pyetësorit studiuesve të IAB-it. Shërbimi është i siguruar në aspektin e mbrojtjes së të dhënave përmes një marrëveshjeje për përpunimin e të dhënave sipas nenit 28 të DSGVO-së, ndërsa Ingress GmbH vepron ekskluzivisht sipas udhëzimeve të IAB-it.

BAMF-i është një autoritet federal qendror në varësinë e Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme (BMI) dhe qendër kompetence për migracionin dhe integrimin.

IAB-i bën pjesë në Agjencinë Federale për Punësim (BA) dhe është përgjegjës për kërkimin shkencor në fushën e tregut të punës dhe profesioneve, për kryerjen e të cilit BA është e ngarkuar ligjërisht (neni 280 SGB III – Kodi Social, Libri i Tretë). Për të garantuar lirinë e shkencës dhe kërkimit të mbrojtur nga Kushtetuta, IAB-i është i ndarë nga sektori administrativ i BA-së në aspektin hapësinor, organizativ dhe të personelit (neni 282, paragrafi 5 SGB III).

Kush është përgjegjës për pyetësorin në kuadër të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave"?

Agjencia Federale për Punësim (Regensburger Straße 104, 90478 Nürnberg, përfaqësuar nga bordi i saj drejtues) është përgjegjëse, në cilësinë e institucionit që drejton IAB-in, për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të këtij pyetësori.

Si i sigurojnë BAMF-i dhe IAB-i të dhënat tuaja të kontaktit?

IAB-i ka marrë të dhënat tuaja të kontaktit — duke respektuar në mënyrë rigorozë mbrojtjen e të dhënave — nga BAMF-i, bazuar në bazën ligjore të nenit 24a, paragrafi 6 të ligjit AZR, dhe mund t'i përdorë këto të dhëna, pas marrjes së pëlqimit tuaj shtesë (për transmetimin paraprak), edhe për ftesën për pjesëmarrje në këtë pyetësor.

Pjesëmarrja juaj është vullnetare!

Si bazë ligjore për pjesëmarrjen tuaj në pyetësor shërben pëlqimi juaj (neni 6, paragrafi 1, germa "a" e DSGVO-së), i cili do të kërkohet para pjesëmarrjes. Pjesëmarrja juaj në pyetësor është vullnetare. Refuzimi për të marrë pjesë nuk ju sjell asnjë disavantazh. Mund të mos u përgjigjeni pyetjeve të caktuara ose mund të ndërpritni plotësisht pjesëmarrjen.

Në IAB ruhen të dhëna administrative rreth jush, të cilat përfshijnë të dhëna nga marrëdhëniet me klientin dhe raportimet nga punëdhënësit (p.sh. periudha punësimi dhe papunësie). Këto të dhëna administrative vihen në dispozicion të IAB-it në përputhje me bazën ligjore të nenit 282, paragrafët 5

dhe 6 të SGB III. Për studiuesit, përgjigjet tuaja në këtë pyetësor kanë një vlerë të veçantë nëse mund të lidhen me të dhënat administrative që IAB-i disponon rreth jush, pasi kjo përmirëson cilësinë dhe vlefshmërinë e rezultateve të kërkimit. Pëlqimi juaj për këtë është vullnetar dhe do t'ju kërkohet po ashtu.

Publikimi i rezultateve të kërkimit, fshirja e të dhënave tuaja

Rezultatet e kërkimit do të publikohen në mënyrë anonime, dhe nga rezultatet e publikuara nuk mund të nxirren të dhëna që lidhen me identitetin tuaj.

IAB-i i fshin të dhënat tuaja të kontaktit sa më shpejtë të jetë e mundur, që do të thotë pas dërgimit të letrave, ndërsa përgjigjet dhe pëlqimin tuaj i fshin pas skadimit të periudhës së ruajtjes së të dhënave. Kjo nuk do të thotë që të dhënat tuaja do të fshihen edhe nga Agjencia Federale për Punësim (BA) dhe qendrat e punësimit, pasi për to ligji parashikon periudha të ndryshme të ruajtjes së të dhënave.

Është planifikuar që të dhënat e përgjigjeve t'u vihen në dispozicion studiuesve të tjerë, pa mundësinë e një lidhjeje me një person konkret, nëpërmjet Qendrës së të Dhënave të Hulumtimit të BAMF.

Të drejtat tuaja

Ju mund të bëni kërkesë për informacion mbi të dhënat që IAB-i ka për ju, si dhe të verifikoni nëse duhet të kryhet korrigjimi, fshirja, transferimi i të dhënave tuaja ose kufizimi i përpunimit, si dhe nëse duhet të pranohet kundërshtimi juaj ndaj përpunimit të tyre. Gjithashtu, ju mund të revokoni pëlqimin tuaj, por deri në momentin e revokimit përpunimi i të dhënave mbetet i ligjshëm.

Për ushtrimin e të drejtave tuaja, ju lutemi të kontaktoni në: **iab.projektfeg20@iab.de**

Përgjegjësi për Mbrojtjen e të Dhënave

Agjencia Federale për Punësim (BA) ka një përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave, të cilin mund ta kontaktoni në adresën postare: "Bundesagentur für Arbeit, Datenschutzbeauftragter, Regensburger Straße 104, 90478 Nürnberg" ose përmes formularit të kontaktit të disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të BA-së:

<https://web.arbeitsagentur.de/portal/kontakt/de/weitere-themen/datenschutz>.

Përgjegjësi për mbrojtjen e të dhënave i Ingress GmbH mund të kontaktohet në adresën më poshtë: Ingress GmbH, Duy Anh Nguyen, Weidestraße 122a 22083 Hamburg, E-Mail: info@ingress.de

Autoriteti Mbikëqyrës për Mbrojtjen e të Dhënave

Ju keni të drejtë të paraqisni ankesë pranë BfDI-së - Komisioneri Federal për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informacionit, Graurheindorfer Str. 153, 53117 Bonn.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe besimin në punën tonë!